

ETR2 – Udhëzim për Llogaritjen e të Ardhurave të Lejuara

10 Tetor 2007

1 Hyrje

Ky shënim përmbledh qasjen e përgjithshme ndaj llogaritjes së të ardhurave të lejuara, si pjesë e aplikacioneve për tarifa të rregulluara të cilat do të paraqiten nga të licencuarit (KEK SHA dhe KOSTT SHA) në ZRrE sipas shqyrtimit të dytë të tarifës së energjisë elektrike (ETR2). Në një shënim të veçantë përshkruhet përlllogaritja e tarifave të propozuara.

2 Llogaritja e Kostove të Lejuara

2.1 Qasja e përgjithshme

Metodologjia e Tarifave përcaktoi parimin kryesor vijues për përlllogaritjen e kostove të lejuara për bizneset e rregulluara:

- Kostot e lejuara përlllogariten sipas një qasjeje të ‘ndërtimit të blloqeve’, ku totali i kostove të lejuara është i barabartë me shumën e *shpenzimeve operacionale efektive (opex) + zhvlerësimi + kthimin e lejuar*.
- Zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar përlllogariten duke iu referuar bazës së asetit të rregulluar (*BAR*).
- Asetet për të cilët i licencuari nuk has në kosto financiare, nuk përfshihen në përlllogaritjen e kthimit të lejuar. Për këtë arsye, baza e asetit të rregulluar e përdorur për këtë përlllogaritje, përlllogaritet si *BAR minus vlerën e aseteve të ‘lira’ (BARI)*. Asetet e lira përcaktohen si këto asete:

- Të blera përpara 2006 dhe të cilat ose janë trashëguar prej regjimit¹ të para 1999 ose të financuar prej granteve vijuese që i janë vënë në dispozicion industrisë.
- Të blera në vitin 2006 dhe më pas kanë përdorur grantet që i janë vënë në dispozicion industrisë.
- Kthimi i lejuar përlllogaritjet si *mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit të taksës paraprahe (WACC) * BARI*. MPKK e përdorur për këtë qëllim përfaqëson përlllogaritjen e supozuar të ZRRE-së për kostot e financimit të një biznesi efikas, dhe jo kostot reale të financimit e të licencuarit.
- Të gjitha asetet në BAR janë të përfshira në përlllogaritjen e zhvlerësimit të lejuar. Për këtë qëllim, aplikohet *mesatarja e ponderuar e jetës së mbetur të asetit*. Kjo është përlllogaritur nga llogaritë statusore.
- *Shpenzimet kapitale* efikase të lejuara (*capex*) i shtohen RAB-it në atë vit në të cilin ato ndodhin².

2.2 Kostot e Furnizimit me Pakicë

Përfshirja në këtë qasje është përlllogaritja e kostove të lejuara (jo për blerjen e energjisë) të Furnizimit të KEK-ut. Kostot e këtij biznesi janë llogaritur si:

- *Kosto e pakicës*, e shprehur si kosto për konsumatorët, për kompensimin e ndaj kostove për menaxhimin e llogarive të konsumatorëve që janë supozuar nga Furnizimi i KEK-ut.
- *Teprica e furnizimit*, e shprehur si përqindje e kostove të blerjes së energjisë që i është përçuar konsumatorëve të rregulluar, për të kompensuar rreziqet e tregut që janë supozuar nga Furnizimi i KEK-ut, si dhe nevojat e veta të kapitalit punues.

Borxhet e këqija nuk konsiderohen si kosto të legjitimuara të Furnizimit të KEK-ut, dhe nuk përfshihen në kostot e lejuara për këtë biznes.

2.3 Kostot e Blerjes së Energjisë

Kostot e lejuara për blerjen e energjisë nga Furnizimi i KEK-ut janë llogaritur si:

¹ If as a result of final status negotiations, licensees are required to either make compensating payments for these assets or assume part or all of existing loans used for the purposes of purchasing these assets, then ERO has committed to allowing an appropriate share of these costs to be included in the allowed revenues to be recovered from regulated tariffs.

² For the purposes of calculating the depreciation allowance and allowed return, the average of the opening and closing RAB for the year is used.

- Kostot e lejuara të minierave të KEK-ut, të llogaritura si më sipër

plus

- Kostot e lejuara të Prodhimit të KEK-ut, të llogaritua si më sipër (duke përfshirë kostot e blerjeve të karburantit prej Minierave të KEK-ut)

plus

- Kostot e planifikuara të importit të energjisë

plus

- Kostot e lejuara të blerjeve të shërbimeve ndihmëse nga KOSTT

minus

- Kostot e lejuara të humbjeve të paguara nga KOSTT dhe Shpërndarja e KEK-ut

2.4 Humbjet

KOSTT dhe Shpërndarja e KEK-ut janë përkatësisht përgjegjës për blerjen e humbjeve që hasen gjatë transmetimit³ dhe shpërndarjes së energjisë. Për këtë, humbjet në shpërndarje janë përcaktuar si diferenca midis energjisë elektrike të matur që hyn dhe del nga rrjeti i shpërndarjes (pra, përfshirë vjedhjen dhe humbjet e tjera komerciale).

Kostot e lejuara për KOSTT-in dhe Shpërndarjen e KEK-ut përfshijnë një provizion për blerjen e humbjeve. Kjo është llogaritur si *mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë * energjia që hyn në rrjet * normën e humbjeve të lejuar* (e shprehur si përqindje).

2.5 Shërbimet Ndhmëse

Kostot e planifikuara të shërbimeve ndihmëse janë të përfshira në kostot e lejuara të KOSTT.

2.6 Alokimi i Kostove për Zyrën Qendrore

Kostot e Zyrës Qendrore të KEK-ut janë llogaritur në të njëjtën mënyrë si ato për bizneset e tjera. Më pas këto u shpërndahen bizneseve individuale të KEK-ut në raport me numrin e personelit për secilin biznes.

³ Duke përfshirë humbjet në transit.

3 Shndërrimi në të Ardhura të Lejuara

3.1 Aktivitetet e Parregulluara

Shndërrimi i kostove të lejuara në të ardhura të lejuara përfshin zbritjen e të ardhurave të planifikuara nga aktivitetet e parregulluara prej kostove të lejuara të secilit biznes:

- Të ardhurat vjetore të planifikuara prej shitjeve të linjtit tek konsumatorë të tjerë përveç Prodhimit të KEK-ut, që janë zbritur nga kostot e lejuara të Minierave të KEK-ut të përfshira në kostot e lejuara për blerjen e energjisë nga Furnizimi i KEK-ut.
- Të ardhurat vjetore të planifikuara prej eksporteve të energjisë dhe prej shitjeve të energjisë tek konsumatorët e privilegjuar, janë zbritur prej kostove të lejuara për blerjen e energjisë nga Furnizimi i KEK-ut.
- Të ardhurat vjetore të planifikuara prej mekanizmit të Kompensimit Ndër-OST (ITC), janë zbritur prej kostove të lejuara të KOSTT.
- Të ardhurat vjetore të planifikuara prej tarifave të transmetimit dhe shpërndarjes që janë paguar nga konsumatorët e privilegjuar, janë zbritur përkatësisht prej kostove të lejuara të KOSTT dhe Shpërndarjes së KEK-ut.
- Të ardhurat vjetore të planifikuara prej tarifave të kyçjes (kur këto janë përdorur për të financuar asetet e reja të rrjetit), janë zbritur prej kostove të lejuara të KOSTT dhe Shpërndarjes së KEK-ut.
- Subvencionet operuese (pra, duke përjashtuar grantet për shpenzimet kapitale) të paguara ndaj KOSTT-it dhe KEK-ut prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK), janë zbritur prej kostove të lejuara të bizneseve përkatëse.

3.2 Korrigjimet dhe përshtatjet kompensuese

Të ardhurat e lejuara vjetore janë përshtatur edhe për:

- Nën-shpenzimet e capex-it të lejuar në periudhën paraprake ku investimi i shoqëruar nuk është bërë dhe nuk është përfshirë në investimet e planifikuara në periudhën vijuese. Nëse investimi është ende i planifikuar, atëherë nuk është bërë asnjë korrigjim por edhe nuk është siguruar asnjë ndihmë financiare shtesë për shpenzimet kapitale.
- Dallimet midis të ardhurave të lejuara të parashikuara dhe reale dhe kostove në periudhën paraprake, që janë jashtë kontrollit të të licencuarit. Këto modifikime përfshijnë:
 - Diferencat në kostot e humbjeve në blerje nga ana e KOSTT dhe Shpërndarjes së KEK-ut që rezultojnë nga diferencat midis çmimeve të planifikuara dhe

reale të blerjes së energjisë dhe të energjisë së transportuar (por jo për shkak të diferencave midis normave reale dhe të lejuara të humbjeve).

- Diferencat midis të ardhurave vjetore neto të planifikuara dhe atyre reale të KOSTT-it, sipas mekanizmit ITC.
- Diferencat midis subvencioneve operuese të planifikuara dhe atyre reale që i janë paguar KOSTT-it dhe KEK-ut prej BKK-së. Diferenca i shtohet të ardhurave vjetore të lejuara.
- Diferencat midis financimeve të granteve të planifikuara dhe atyre reale për investimet e reja që i janë paguar KOSTT-it dhe KEK-ut prej BKK-së. Diferenca shndërrohet prej një aseti të lirë të supozuar, në një aset që ka të drejtën të fitojë të ardhura.

Në secilin rast, diferenca shumëzohet me një plus normën njëvjeçare të huamarrjes që i ngarkohet nga bankat komerciale në Kosovë. Kjo pasqyron supozimin se i licencuari ose duhet të marrë hua për të kompensuar për mungesat në të ardhurat vjetore të lejuara që janë jashtë kontrollit të vet, ose mund të depozitojnë tepricat dhe të marrin fitim nga këto.

4 Ndryshimet prej ETR1

Shqyrtimi i parë i tarifës së energjisë elektrike (ETR1) parashikoi se të ardhurat vjetore të lejuara që janë hasur nga KOSTT dhe Shpërndarja e KEK-ut në rolin e tyre si pronarë rrjeti, do të përcaktoheshin për një periudhë trevjeçare. ZRRE-ja më pas përcaktoi se do të ishte më e përshtatshme që kostot e lejuara dhe të ardhurat vjetore të lejuara për këto biznese të shqyrtoheshin si pjesë e ETR2, në të njëjtën mënyrë si për bizneset e tjera të rregulluara (pra, një vit përpara). Kjo pranon pasiguritë e mëdha të kohës së ETR1 dhe pasigurinë e shumicës së të dhënave të paraqitura nga të licencuarit gjatë rrjedhës së atij shqyrtimi.

Për këtë arsye, do të jetë e domosdoshme që të modifikohen të ardhurat vjetore të lejuara për KOSTT-in dhe Shpërndarjen e KEK-ut për të kompensuar për mbulimin e dobët të kostove të lejuara për vitin 2007 si rrjedhojë e aplikimit të 'sheshimit' të të ardhurave vjetore për periudhën 2007-09.

Po ashtu është propozuar të përdoret kostoja nominale e aseteve për qëllimet e përcaktimit të BAR-it dhe për të përcaktuar Mesatare të Ponderuar të Kostove të Kapitalit e cila do të përdorur për të llogaritur fitimin e lejuar. Më përpara janë përdorur vlera reale e asetit dhe MPKK-ja, me një rregullim inflacioni që aplikohet përmes indeksimit. Ky ndryshim është i qëndrueshëm me qëllimin për të përcaktuar të ardhurat vjetore të lejuara për secilin biznes sipas ETR2 për një periudhë njëvjeçare.